

VENDIM
Nr. 294, datë 2.5.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT, PËR HEQJEN E
VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE SPECIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Katarit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe speciale, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
SHTETIT TË KATARIT PËR HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE SPECIALE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Katarit (këtu më poshtë referuar si Palët),

duke dëshiruar forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të tyre miqësore, kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, përfshihen pasaportat e mëposhtme:
Për Republikën e Shqipërisë: pasaportat e vlefshme diplomatike.
Për Shtetin e Katarit: pasaportat e vlefshme diplomatike dhe speciale.

Neni 2

Qytetarët e të dyja palëve, që janë mbajtës të pasaportave të specifikuara në nenin 1 më lart, mund të hyjnë në territorin e palës tjetër pa viza dhe mund të qëndrojnë atje për një periudhë deri nëntëdhjetë ditë nga data e hyrjes.

Neni 3

Qytetarët e të dyja vendeve që janë mbajtës të pasaportave të specifikuara në nenin 1 më lart, që janë të emëruar të punojnë në misionet diplomatike, tregtare, konsullore ose në organizatat ndërkombëtare të akredituara në territorin e palës tjetër, mund të hyjnë dhe të qëndrojnë në territorin e kësaj pale pa viza gjatë periudhës së detyrës së tyre.

Neni 4

Anëtarët e familjeve të personave të specifikuar në nenin 3 më sipër, që banojnë me ata dhe janë

mbajtës të pasaportave të specifikuara më lart në nenin 1, mund të hyjnë dhe të qëndrojnë në territorin e palës tjetër pa viza gjatë periudhës së detyrës së këtyre personave.

Neni 5

Në kundërshtim me dispozitat e nenit 2 të kësaj marrëveshjeje, qytetarët e të dy vendeve që janë mbajtës të pasaportave të specifikuara më lart në nenin 1 dhe që dëshirojnë të hyjnë në territorin e secilës palë për qëllime pune, profesionale ose studimi, janë të detyruar të sigurojnë më parë vizë.

Neni 6

Qytetarët e të dyja palëve që janë mbajtës të pasaportave të specifikuara më lart në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, do të kalojnë kufijtë e territorit të secilës palë në pikat ligjore të kalimit kufitar të hapura për trafikun transit ndërkombëtar.

Neni 7

Secila palë ka të drejtë të refuzojë hyrjen ose qëndrimin në territorin e vet të qytetarëve të palës tjetër, për arsye të sigurisë së shtetit, të rendit dhe shëndetit publik.

Më tej, çdo palë ka të drejtë të reduktojë ose përfundojë periudhën e qëndrimit të qytetarëve të palës tjetër, në përputhje me ligjet dhe rregullat e vendit pritës.

Neni 8

Qytetarët e të dyja vendeve që janë mbajtës të pasaportave të specifikuara në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, respektojnë ligjet dhe rregullat gjatë hyrjes dhe qëndrimit të tyre në territorin e palës tjetër.

Neni 9

1. Çdo palë ka të drejtë të pezullojë plotësisht ose pjesërisht zbatimin e kësaj marrëveshjeje, për arsye të sigurisë së shtetit, të rendit dhe të shëndetit publik. Një vendim i tillë i bëhet i njohur me shkrim palës tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike, brenda 72 orëve, para hyrjes së tij në fuqi.

2. Pala që ka vendosur të marrë masat e specifikuara në paragrafin 1 të këtij neni, njofton menjëherë me shkrim palën tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për shfuqizimin e këtyre masave dhe rinisjen e kësaj marrëveshjeje.

Neni 10

1. Me qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe para se ajo të hyjë në fuqi, autoritetet kompetente të secilës palë shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike, ekzemplarët përkatës të pasaportave të tyre të vlefshme diplomatike dhe zyrtare brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

2. Në qoftë se njëra palë rinovon ose ndryshon pasaportat e veta diplomatike ose speciale, autoritetet e saj kompetente informojnë dhe dërgojnë ekzemplarët e rinj tek autoritetet kompetente të palës tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike para 30 ditëve nga data e futjes së tyre në qarkullim.

Neni 11

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me konsensusin e të dyja palëve dhe ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat e specifikuara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 12

Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data e njoftimit të fundit që njëra palë i dërgon palës tjetër, nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke deklaruar përfundimin e procedurave të saj të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe mbetet në fuqi për një periudhë prej 5 vjetësh dhe rinovohet automatikisht për periudha të ngjashme.

Secila palë mund ta anulojë këtë marrëveshje duke i dërguar njoftim me shkrim palës tjetër dhe në

këtë rast marrëveshja pushon së qeni në fuqi pas 30 ditësh nga data kur pala tjetër merr njoftimin për anulimin e saj.

Nënshkruar në Doha, më 26 mars 2012, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqip, arabisht dhe anglisht, duke qenë të gjitha të barabarta dhe në rast të ndryshimeve në interpretim, teksti anglisht do të ketë përparësi.